



RoadMap for improving the quality and responsiveness of VET – Theory and Practice

Newsletter 2

Numri: 2 | Qershor 2026



Projekt Nr: 101183369



Bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian

Financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm ato të autorit/autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian apo të Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Arsimin dhe Kulturën (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as autoriteti financiar nuk mund të mbahen përgjegjës për to.

Rreth Projektit

Financuar nga Komisioni Evropian në kuadër të Programit Erasmus+ – Capacity Building në fushën e Arsimit dhe Formimit Profesional (VET), RAPPORT – RoadMap for Improving the Quality and Responsiveness of VET – Theory and Practice (Marrëveshja e Grantit Nr. 101183369) synon të përmirësojë cilësinë dhe aftësinë e reagimit të sistemeve të VET ndaj zhvillimeve socio-ekonomike dhe nevojave të tregut të punës.

RAPPORT zbatohet në kuadër të Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Arsimin dhe Kulturën dhe bashkon një partneritet shumëpalësh të organizatave aktive në fushën e VET nga Qipro, Greqia, Italia, Shqipëria dhe Bosnja & Hercegovina.

Projekti mbështet ofruesit e VET, Dhomat e Tregtisë, trajnerët dhe aktorët e tjerë të interesit në:

- Forcimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë
- Modernizimin e kurrikulave
- Rritjen e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve
- Integrimin e aftësive të gjelbra, digjitale dhe sipërmarrëse
- Promovimin e validimit të të nxënësve joformal
- Përmirësimi i shërbimeve të orientimit në karrierë
- Sigurimi i një VET gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm

Përmes një qasjeje “teori – pastaj praktikë”, RAPPORT kombinon ngritjen e kapaciteteve me zhvillimin dhe zbatimin praktik të kurrikulave, duke siguruar që njohuritë e përfituara të përkthehen në rezultate konkrete dhe të qëndrueshme në sistemet e Arsimit dhe Formimit Profesional.

Objektivat:

1. Rritja e kapaciteteve të partnerëve në sigurimin e cilësisë, hartimin e kurrikulave, angazhimin e aktorëve të interesit dhe praktikën gjithëpërfshirëse në VET.
2. Zhvillimi i kurrikulave të përshtatshme dhe reaguese që përmbushin standardet e kualifikimit, pasqyrojnë nevojat e tregut të punës dhe integrojnë mësimin e bazuar në punë si dhe validimin përmes mikrokredencialeve.
3. Forcimi i ekspertizës në e-learning për krijimin e materialeve trajnuese asinkrone me cilësi të lartë.
4. Promovimi i mësimin të bazuar në punë, duke mbështetur ofruesit e VET në hartimin dhe ofrimin e programeve praktike, të përshtatura me kërkesat e tregut të punës.
5. Krijimi i një platforme online për shpërndarjen e burimeve, materialeve trajnuese dhe praktikave të mira.
6. Forcimi i validimit të të nxënësve joformal përmes mikrokredencialeve dhe instrumenteve ISO 17024.
7. Përmirësimi i orientimit në karrierë për të harmonizuar më mirë aftësitë e nxënësve me mundësitë e punësimit.
8. Nxitja e kompetencave transversale – digjitale, të gjelbra dhe sipërmarrëse – përmes kurrikulave të reja dhe mikrokredencialeve të akredituara.
9. Krijimi i një Komuniteti të Praktikës (Community of Practice) për shkëmbimin e përvojave, testimin e inovacioneve dhe sigurimin e bashkëpunimit të qëndrueshëm ndërmjet rajoneve.

Takimi i Tretë Transnacional i Projektit

Më 28–29 prill, takimi i tretë transnacional i projektit u organizua nga partneri DIMITRA në Larisa, Greqi. Aktiviteti mbledhi 15 përfaqësues të partnerëve, të cilët shqyrtuan progresin e arritur në të gjitha paketat e punës.

Vëmendje e veçantë iu kushtua rezultateve të përfunduara të Paketës së Punës 2 (WP2) dhe aktiviteteve në vazhdim të Paketës së Punës 3 (WP3), të cilat përfshijnë zhvillimin e kurrikulave, materialeve mësimore asinkrone, mikrokredencialeve, instrumenteve të vlerësimit, me synimin për të forcuar aftësitë e gjelbra, digjitale dhe sipërmarrëse.

Partnerët shqyrtuan rezultatet e planifikuara, afatet dhe kërkesat për koordinim për periudhën e ardhshme të zbatimit, duke siguruar harmonizimin e aktiviteteve në të gjitha paketat e punës. Sesiioni ofroi një perspektivë të orientuar drejt së ardhmes, duke paraqitur një përmbledhje të aktiviteteve pilot të planifikuara në kuadër të Paketës së Punës 4 (WP4), të cilat do të testojnë dhe validojnë kurrikulat dhe mjetet e zhvilluara rishtazi në mjedise reale të të nxëniet. Përveç kësaj, partnerët diskutuan aktivitetet e shpërndarjes së rezultateve në kuadër të Paketës së Punës 5 (WP5), duke u fokusuar në strategjitë për ndarjen efektive të rezultateve të projektit me palët e interesuara, rritjen e dukshmërisë së projektit dhe maksimizimin e ndikimit të tij, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel ndërkombëtar.





PIKAT KRYESORE TË PROJEKTIT

Jemi të lumtur të ndajmë me ju progresin e rëndësishëm të arritur deri më tani në kuadër të projektit tonë.

Paketa e Punës 3 (WP3), e cila aktualisht ndodhet në fazën e zbatimit, fokusohet në zhvillimin e përbashkët të kurrikulave dhe materialeve mësimore për zhvillimin e aftësive të gjelbra dhe digjitale të nxënësve, me theks të veçantë në mësimin e bazuar në punë dhe mësimin elektronik asinkron.

Aktivitetet kryesore në kuadër të WP3 përfshijnë:

Kurrikulat dhe materialet mësimore: Hartimin e moduleve asinkrone që forcojnë aftësitë e gjelbra, digjitale dhe sipërmarrëse.

Mikrokredencialet: Zhvillimin e mjeteve fleksibile për njohjen dhe validimin e grupeve specifike të aftësive, duke rritur mundësitë për punësim.

Skema e Certifikimit RAPPORT: Krijimin e një kuadri të strukturuar për certifikimin e kompetencave në përputhje me standardet evropiane.

Instrumentet e vlerësimit: Zhvillimin e mjeteve për validimin dhe certifikimin e arritjeve të nxënësve në aftësitë e gjelbra, digjitale dhe sipërmarrëse.

Integrimi i Mësimin të Bazuar në Punë (Work-Based Learning): Integrimin e komponentëve praktikë, të orientuar drejt vendit të punës, në të gjitha kurrikulat e RAPPORT-it, për të garantuar relevancën dhe zbatueshmërinë e tyre në praktikë.

Platforma për elearning:

<https://elearn-rapport.projectsgallery.eu/>

HAPAT E ARDHSHËM

Konsorciumi ka avancuar me **Paketën e Punës 4 (WP4)**, e cila fokusohet në forcimin e aftësive të trajnerëve, mentorëve në vendin e punës dhe nxënësve. Gjatë takimit, partnerët shqyrtuan aktivitetet pilot të planifikuara dhe ranë dakord për metodologjinë që do të zbatohet gjatë gjithë fazës pilot.

Diskutimet përfshinë organizimin e plotë të trajnimeve pilot, duke përfshirë:

- Rekrutimin e nxënësve dhe trajnerëve
- Përkthimin e materialeve të trajnimit
- Ngarkimin e përmbajtjes në **platformën Moodle**
- Zhvillimin e punëtorive (workshopeve) sinkrone
- Aktivitetet e vlerësimit dhe certifikimit
- Mbledhjen e komenteve dhe rezultateve të vlerësimit

Një vendim i rëndësishëm u mor në lidhje me sesionet e **trajnimit për trajnerët**, të cilat do të zhvillohen online në datat e mëposhtme:

- **Aftësitë e Gjelbra** – 23 shtator 2026
- **Aftësitë Digjitale** – 30 shtator 2026
- **Aftësitë Sipërmarrëse** – 07 tetor 2026

Këto sesione përfaqësojnë një hap të rëndësishëm në përgatitjen e trajnerëve për të ofruar përvoja mësimore cilësore dhe të orientuara drejt së ardhmes, duke siguruar që si edukatorët ashtu edhe nxënësit të pajisen me kompetencat e nevojshme për të përballuar tranzicionin e gjelbër dhe atë digjital.

QËNDRONI TË LIDHUR ME NE

Ju ftojme të vizitoni faqen tonë të internetit të projektit <https://rapport.projectsgallery.eu/> ër të aksesuar këto burime dhe për të mësuar më shumë rreth iniciativave tona.


Angazhimi dhe komentet tuaja janë shumë të rëndësishme për ne, ndërsa vazhdojmë të zhvillojmë dhe përmirësojmë aktivitetet dhe rezultatet e projektit. Gjithashtu, ju inkurajojmë të bëheni pjesë e komunitetit tonë aktiv në rrjetet sociale.

Na ndiqni në rrjetet sociale:

Facebook: <https://shorturl.at/V6deq>

LinkedIn: <https://shorturl.at/M90XA>

Website: [Rapport](#)



Koordinatori:

MMC Mediterranean
Management Centre

Contact Us:

Address: 16, Imvrou Street, 1055 Nicosia, Cyprus

Tel. No: +357 22466633

E-mail: europeanprojects@mmclearningsolutions.com

Website: www.mmclearningsolutions.com

Partnerët:



ПРИВРЕДНА КОМОРА РЕПУБЛИКЕ СРПСКЕ
ПОДРУЧНА ПРИВРЕДНА
КОМОРА БАЊА ЛУКА



Asnor
Associazione Nazionale Orientatori



**Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian**

Financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm ato të autorit/autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian apo të Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Arsimin dhe Kulturën (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as autoriteti financues nuk mund të mbahen përgjegjës për to.